



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/ Republic of Kosovo**

**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tuzilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council**

KPK/Nr. 801/2022  
Datë: 14 korrik 2022

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 34 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 2 të Ligjit Nr. 08/L-003 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 12 paragrafi 10 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në takimin e mbajtur me datë 14 korrik 2022, mori këtë:

**VENDIM**

- I. Z. Ramiz Buzhala, Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, suspendohet menjëherë nga ushtrimi i detyrave zyrtare me pagesë 50% të pagës të tij, deri në një vendimi të ri të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
- II. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në uebportalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

**Arsyetim**

Me datë 14.07.2022 Autoriteti Kompetent, Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, i ka paraqitur Këshillit Prokurorial të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore ndaj Kryeprokurorit në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, Ramiz Buzhala për shkak të dyshimit të arsyeshëm se me datë 13.07.2022 ka shpërndarë pyetje nga testi me shkrim që duhej të mbahej në të njëjtën ditë nga aplikantët për bashkëpunëtorët profesional në Prokuroritë Themelore në Gjakovë, Prizren dhe Pejë, ashtu që përmes ëhats app-it, pyetjet e testit me shkrim i kishte dërguar në adresë të gazetares së mediumit KALLXO.com Adelina Ahmeti dhe pastaj përmes komunikimit me telefon kishte kërkuar nga e njëjta që ti fshij pyetjet/mesazhet e dërguara duke theksuar se ishin dërguar gabimisht te e njëjta, e me të cilat veprime i njëjti kishte për të kryer shkelje disiplinore nga neni 6 paragrafi 2 nënparagrafi 2.10 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve - Përfshihet në sjellje, qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e Prokurorit të Shtetit ose që mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e Prokurorit të Shtetit.

Këshilli Prokurorial i Kosovës në takimin e mbajtur me datë 14.07.2022 ka aprovuar kërkesën e Ushtruesit të Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi për fillimin e hetimeve disiplinore ndaj Kryeprokurorit Buzhala, dhe bazuar në legjislacionin në fuqi, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Jetish Maloku

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës



T'i dërgohet :

- Z. Besim Kelmendi – U. D. Kryeprokuror i Shtetit;
- Z. Ramiz Buzhala – Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Gjakovë;
- Arkivës.